



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
SHKODËR

NJOFTIM

“PËR NDRYSHIMIN E SELISË SË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM SHKODËR DHE TRANSFERIMIN E DHOMAVE PENALE DHE CIVILE ”

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, në kuadër të transparencës së veprimtarisë së saj ju informon se:

Në bazë të Vendimi të Këshillit të Gjykatës, nr 23/1 datë 20.11.2024 ka vendosur : Ndryshimin e selisë së gjykatës së Shkallë së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër në godinën e Ish Gjykatës së Apelit Shkodër në dy faza:



Faza e Parë: Më datë 25.11.2024 fillon veprimtarinë gjyqësore Dhoma Penale (Seksioni Penal) .

- Të gjitha çështjet penale që janë aktualisht në shqyrtim si dhe çështjet penale të rregjistruara të reja prej datës **25.11.2024**, do të gjykohen në godinën e ish – Gjykatës së Apelit Shkodër me adresë :

Adresa: Lagja “Salo Halili”, rruga “Et’hem Osmani”, Bashkia Shkodër

Faza e dytë: Më datë **02.12.2024** fillon veprimtarinë gjyqësore Dhoma Civile (Seksioni Civil)

- Të gjitha çështjet civile që janë aktualisht në shqyrtim si dhe çështjet civile të rregjistruara të reja prej datës **02.12.2024** do të gjykohen në godinën e ish – Gjykatës së Apelit Shkodër me adresë :

Adresa: Lagja “Salo Halili”, rruga “Et’hem Osmani”, Bashkia Shkodër

E-Mail: Info.Gjykata.Shkoder@gjykata.gov.al

Në godinën e ish - Gjykatës së Apelit Shkodër do të funksionojnë normalisht edhe:

- **SPORTELI PËR KRYERJEN E VEPRIMEVE ADMINISTRATIVE**

(për të gjithë përdoruesit e Gjykatës),

Adresa elektronike:

E-mail:

Info.Gjykata.Shkoder@gjykata.gov.al

Njoftime.Gjykata.Shkoder@gjykata.gov.al

Orari i shërbimeve: Nga e hëna më të premte.

Ora 08:00 – 16:00.

SPORTELI PËR KRYERJEN E VEPRIMEVE ADMINISTRATIVE

(për të gjithë përdoruesit e Gjykatës) Nga e hëna më të premte. Ora 08:00 – 16:00

Sporteli do të ofrojë shërbimet si më poshtë:

- Kërkesat për gjykim të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.
- Kërkesa dhe akte të tjera procedurale/provuese në numër sa janë palët ndërgjygjëse sa i përket gjykimeve në fazën e hetimit paraprak apo fazën e ekzekutimit me iniciues palën e akuzuar /dënuar.
- Depozitim Kërkesa/Kërkesëpadi dhe akte të tjera procedurale/provuese në numër sa janë palët ndërgjygjëse.
- Kërkesat për plotësim, sqarim, interpretim vendimi dhe ndreqje gabimi.
- Kërkesë për kopje vendimi/akteve nga Kryesekretaria.
- Kërkesë për kopje vendimi/akteve nga Zyra e Arkivës.
- Kërkesë për kopje të akteve për çështje gjyqësore në process.
- Ankimet/kundërankimet.
- Kërkesë për vërtetim mbi çështjet e gjykuara apo në gjykim.
- Kërkesë për informacion mbi çështjet e regjistruar në gjykatë.
- Kërkesë për përshpejtim të çështjeve gjyqësore të regjistruara.
- Kërkesat për depozitim të dhënave të kontaktit të palëve apo përfaqësuesve të tyre për çështjet gjyqësore në proces si dhe çdo të dhënë për ndryshimin e adresave të vendbanimit.
- Depozitim të aktit të përfaqësimit të çështjeve gjyqësore të regjistruara.
- Kërkesa për përjashtim të trupi gjykues në çështjet penale/civile.
- Kërkesat për heqje dorë nga ankimi.
- Kërkesat për informacion të publikut dhe medias.
- Kërkesat për çështjet gjyqësore në process.
- Aplikime, etj.
- Kërkesat për heqje dorë nga ankimi.
- Kërkesat për informacion të publikut dhe medias.
- Aplikime, dhe shërbime të tjera gjyqësore, etj.